

PËRPARIMI

Reviste kulturore

ИМВ. ОРОЈ
ОИГН.

181/62

NUMER 2

Fruer 1956

VJETI II

ANTARËT E REDAKSIS:

Ismet Shaqiri, Hüzi Sulejmani, Vojislav Dançetoviqi, Elhami Nimani, Mehmet Hoxha, Stathi Kostari, Abdullah Zajmi, Mehmedali Hoxha, Lorenz Antoni, Mehdi Bardhi, Xheladin Topçiu, Ali Rexha, Mark Krasniqi, Jusuf Shushka, Hasan Vokshi, Ismet Mula, Shevqet Veliu, Masar Murtezai

KËSHILLI REDAKTUES:

Stathi Kostari, Ali Rexha, Xheladin Topçiu, Hasan Vokshi

DREJTORI PËRGJEGJËS

Elhami Nimani

PËRMBAJTJA:

Dr. IVAN POPOVIĆ:

Elementet vendase në fjalorin e gjuhës shqipe

P. S. KOHAN:

Hamleti

JASHAR REXHEPAGAJ:

Mbi disa çashtje të përbajtjes së mësimit
t'edukatës shoqnore morale

SIMA QIRKOVIQ:

Pasqyrë e marrëdhaneve sérbo-shqiptare
— gjatë shekujve XVI—XVIII —

ELEMENTET VENDASE NE FJALORIN E GJUHËS SHQIPE

Në kët artikull po vazhdojmë me shqyrtimin sistematik të disa çashtjeve nga lamija e linguistikës historike shqiptare. *)

Këso here mendoj me u marrë me fjalët indigjene të gjuhës shqipe, don me thanë me at fond të fjalorit, që Shqiptarët s'e kanë marrë prej popujve tjerë, por që e kanë trashigue prej të parëvet (Thrakasve), dmth. në perspektivën e mâtejshme, që ka marrë bashksija e përgjithshme indo-europjane.

Para se të hyj në paraqitjen konkrete të materialit, së pari, më duhet, me e shtrue çashtjen parimisht, që konцепционet t'u jenë të qarta edhe atyne lexuesave, të cilët, në të vërtetë, nuk mirren me linguistikë

Si në çdo gjuhë tjetër, ashtu edhe në shqipet egzistojnë — simbas origjinës — dy lloje fjalësh. Nji palë janë fjalët vendase (të njoftuna në shkencë nën emnin indigjene, dmth. „të linduna”), kurse pala tjetër janë fjalët e huajtuna (sërbisht pozajmice, kroat. posudjenice, frangj. emprunts, gjerm. *Lehnwörter*, ital. *prestiti*). Fjalët vendase nuk janë marrë prej asnjë gjuhe tjetër, por janë trashigim i vjetër, kurse fjalët e huajtuna janë marrë prej ndonjë gjuhe së huej.

Ky princip, natyrisht, në teori âsht shum i thjeshtë, por në praktikë shpeshherë âsht tepër vështirë me u zbatue. Përse? Sepse populli që flet në ndonji gjuhë (çfardo gjuhe qoftë) — nuk âsht kurdoherë i vetëdijshëm për faktin se ndonjana

*) Kam për qëllim që, në marrëveshje me redaksin e revistës „Përparimi” në nji cikël artikujsh, të paraqes pak a shum nji sistem të përbledhun njohunish rrëth zhvillimit të gjuhës shqipe, ashtu si na jep mundsi gjendja e tashme e shkencës ndërkombtare për gjuhsit. Shpresoj se nji varg i tillë artikujsh do t’interesojë, jo vetëm profesionistat e gjuhës e të letërsisë (të cilët simbas profesionit të tyne lypset t’interesohen për këto çashtje), por edhe intelektualët shqiptarë në përgjithsi, aq më tepër, mbassi deri më sod nuk ka pasë këso parashtresash në gjuhën shqipe, bille jo sistematikisht. Lexuesat që do të ruejnë kësombullat, kopjet — kompletin e „Përparimit”, do të kenë kështu, deri diku, nji farë teksti (materiali) të historisë së gjuhës shqipe të përshtatshëm për arsimtarët. I. P.

fjalë âsht e huej. Nëqoftëse thomi *automobil*, atëherë çdokujt i âsht e qartë se kjo fjalë âsht e huej, sepse âsht e ré; por në gjuhën shqipe ka fjalë të vjetra të huajtuna, të cilat ndjenjës intime gjuhsore të çdo Shqiptari i duken si të vendit (sepse krejt kjo kryhet *vetëdijshëm*), e prapseprap analiza e nxjerr si të huej. Nji shembull i mirë i këtij lloji âsht fjala *mokënë* (tosk. *mokërë*). Askush që s'âsht ekspert gjuhsuer, nuk do të mundte me ia qëllue se kjo, simbas origjinës, âsht fjalë greqishte, prej së cilës âsht sajue edhe fjala europjane *mashina*. Këtë do të mundte me e nxjerrë vetëm specialisti gjuhsuer.

Për kët arsyen âsht e nevojshme me diferençue parimisht fjalët e vendit prej atyne të huajtunave. Megjithate kjo punë nuk âsht e lehtë prore, as për specialistin, por prapseprap, në rastet mā të shpeshta, ai ia del në krye. Këtë po e tregoj në disa shembuj.

Të marrin, p.sh. ndonji fjalë shqipe fare të përditëshme, si âsht fjala *ujë*. Fjala *ujë* âsht sajue prej mā së vjetrës *udë*, e kjo edhe prej mā së vjetrës *uda*. Kjo trajtë *uda* mund të krahasohet fare mirë me fjalën sllavisht *voda*, anglishtë e hollandishtë *water*, greqishte *hydor*. Por fjala *ujë* nuk âsht marrë as prej sllavishtes, as prej gjuhëve gjermanike, as prej asaj greqishte, sepse prej këtyne fjalëve të hueja nuk do t'ishte e mundun që të fitohet trajta shqipe me rrugën ligjore. Mirëpo, âsht çashtja për farefisnín e stërlashtë të këtyne fjalëve, dmth: edhe fjala *ujë* (e vjetra *uda*) edhe *voda*, edhe *water*, edhe *hydor* âsht sajue, secila në mënyrën e vet, prej së njajtës — asaj primare t'indoeuropeishtes. Sëkëndejmi rrjedh se secila prej këtyne gjuhëve (shqipe, sllavishtë etj.) ka ndjekë rrugën e saj vehtjake, dmth. ka zbatue ligjët e saja individuale.

Ose, për shembull, mbiemnin *i mirë*. Ky në vijën mā të ngushtë âsht i njij gjinije me ate sërbisht *mio* (mila, milo), por as fjala shqipe nuk âsht sajue prej sërbishtes, e as anasjelltas. Shqiptarët në kët rast prej rrâjës indoeuropeishte *mi* — kanë bâ fjalën e tyne *me nji mbrapashtesë* (—r—), e Sllavët me *r:brapashtcsën* tjetër (—l—). Domethanë se kjo nuk mund të jetë fjalë e huajtun, por gjithashtu âsht fjalë vendase.

Fjalët *bir* e bijë kanë afërsisht farefisní me lat. *filius* e *filia* (frang. *fis*, fille, ital. *figlio*, *figlia* etj.) dhe rezultojnë prej rrâjës indoeuropeishte *bhi-*. Por derisa *bh* në latinishtet zhvillohet, simbas ligjëve të gjuhës latinishte në *f*, në gjuhën e stërlashtë shqipe veproi ligj krejt tjetër, në të *bh* zhvillohet në *b*. Prandej âsht e pamundun që fjala shqipe të jetë marrë prej gjuhës latinishte ose anasjelltas. Por fjala *bir* në shqipet

âsht fjalë vendase, poashtu sikurse âsht *filius* në latinishtet fjalë vendase. Që të dyja janë marrë prej fondit të vjetër indoeuropjan, kanë farefisi, por nuk janë kurrfarë fjalësh të huajtuna.

Përkundrazi, nëqoftëse marrim fjalën *breg* (*brek*) prej rrâjës indoeuropeishte *berg* — p. sh. *gjerm.* *Berg.* („kodër“) atëherë na bie në sy mejherë se kjo fjalë nuk mund të jetë shqipe vendase, për arsyen se në të *er* âsht ndryshue në *re* (e ashtuquejtuna „metatezë“), e ligj i këtillë nuk egziston në gjuhën shqipe, por âsht karakteristik për gjuhët sllavishte. Pra, sadoqë kjo fjalë t'u duket Shqiptarëve si „vendase“ në të vërtetë nuk âsht, por âsht e huajtun prej sllavishtes (në rastin konkret prej sërbokroatishës ose maqedonishës).

Ose, bije fjala *sharrë* („testera“). Kjo i përgjigjet latinishtes *serra*. Por, nëse do t'ishte zhvillue me ligjët shqipe vendase, atëherë s-ës latinishte do t'i përgjigjej *gj-ja* e shqipes (e jo *sh-*), si p.sh. te fjala *gjumë* simbas latinishtes *somnus* (me kuptim të njajtë). Pra edhe këtu nuk âsht çashtje për fjalën vendase, por fjala *sharrë* âsht e huajtun prej gjuhës latinishte. E tjera.

Sëkëndejmi mund të nxirret kjo rregull: fjalë vendase janë ato fjalë të gjuhës shqipe, për të cilat mund të sprovohet se janë zhvillue ekskluzivisht simbas ligjëve të gjuhës shqipe (si prej paraardhses së saj — gjuhës thrakishte) prej fondit të përbashkët t'indoeuropeishtes, derisa në rastin e fjalëve të huajtuna, fjalët mbajnë në vendi vulën e ligjëve të gjuhëve të hueja (ngandonjiherë iu bashkohen edhe disa ligje të shqipes në çka këtu nuk mund të hyhet).

Duhet përmendë se egziston edhe rasti i tretë, ai kur nuk jemi në gjendje të thomi nëse ndonji fjalë e gjuhës shqipe âsht huajtë prej ndonjij gjuhe të huej (praktikisht më shpesh prej latinishtes), ose vetëm âsht në farefisni me ndonji fjalë t'asaj gjuhe së huej, por në të vërtetë âsht fjalë vendase. Kështu fjala shqipe *nuse* nuk na âsht mjaft e qartë, nëse âsht sajue drejtpërsëdrejti prej indoeuropeishtes *nubtja*, ose âsht marrë prej latinishtes *nuptia*, e cila në të vërtetë âsht prej së njajtës origjinë. Të dy rastet do të jepshin fjalën shqipe *nuse*. E njajta gjâ vlen edhe për fjalën (me) *martue*, krahasue me lat. *maritare*. Për fat të mirë, për shkencën, rastet e këtilla prapserap janë mjaft të rralla, kështu që në numrin më të madh të shembujve situata âsht pak a shumë qartë.

Mbassi të kemi sqarue kështu kët çashtje teorike, tash mund të kalojmë në vetë materialin e fjalorit të gjuhës shqipe.

Tue lanë shtresat e ndryshme të fjalëve të huajtuna (pratë fjalëve të hueja) në shqipet për raste tjera, këso here po ndalem i në fjalët shqipe vendase (indigjene), të cilat Shqiptarët, në të kaluemen e lashtë, tue ardhë prej diku kah Veriu i Europës, i prunë me vëhte në Ballkan.

Duhet thanë si nji rregull përbledhse se ndërmjet fjalëve që shënojnë dukunjtë e përditshme (dmth. që nuk u përkasin konceptioneve) — gjithmonë në tana gjuhët më së shumti ka elemente vendase.

Tue u mbështetë n'arsyetimet e sipërme, këtu do të paraqesim pak material nga lamija e fondit të fjalorit vendas të gjuhës shqipe. Ky fond është shum më i madh se sa konsideronte shkenca para nj'a pesëdhetë vjetësh. Të lamë më nji anë aparatin argumentues dhe krahasimin me gjuhët farefisnore e të paraqesim, për shkak thjeshtimi, vetëm materialin e gjuhës shqipe.

Këtu pikëspari janë emnat e burrit, grues e të breznive të tyne: *njeri*, *burr*, *grue*, *djalë*, *bir*, *bijë*, *trim* (jo fëmijë!), e më tutje atë, *nanë*, *vlla*, *motër*, *gjysh*, *stërgjysh*, *nip*, mandej *dhandërr*, *nuse*, *vjehërr*. Edhe terminet për shtëpijakun e shtëpijakën zot e zojë janë me origjinë vendase (sllav. domaćin në gjuhën shqipe ka marrë kuptim tjetër).

Fjalë vendase, simbas rregullit, janë gjith ato që shënojnë pjesët e trupit: *kokë*, *krye*, *krie*, *sy*, *ballë*, *hundë*, *vesh*, *buzë*, *nofull*, *gjuhë*, *dhambë*, *qafë*, *fyt*, *grykë*, *bark*, *zemër*, *gjî*, *dorë*, *krah*, *gisht*, *bryl*, *thue*, mandej *gjû*, *gjak*, *dell*, *lëkurë* etj. (por jo *kâmbë*, *shuoll!*)

Edhe funksionet e ndryshme të trupit të njeriut vijnë kryesisht në këtë varg: *rrnoj* e *vdes*, *ha* e *pi*, *hangër* e *ede?*, *shiqoj* e *flas*, *shkoj* e *flej*, *qaj* e *qeshi*, *frymë* e *koll* etj. Edhe këtu nuk duhet me pritë shum fjalë të huajtuna, të paktën jo në nji masë të madhe.

Sikurse shifet, populli këtu nuk ka pasë nevojë me marrë fjalë prej gjuhëve të hueja, sepse kudo — këtu është fjala përkonceptione dhe objekte që ka pasë gjithmonë parasysh.

Por me këtë, natyrisht, nuk mbaron krejt puna. Gati gjith natyra që rrethon Shqiptarin, ka emna që ai vetë, pa ndikimin e huej, ia ka dhanë tue u shërbye me mjete gjuhësore të trashigueme prej të parëve. Po paraqesim edhe nji varg terminesh së tillë: *botë*, *tokë*, *ujë*, *bjeshkë*, *fushë*, *qafë*, *gurrë*, *det* (?), *lum*, *luse*, *diell*, *rê (-ja)*, *hâñez*, *shi*, *borë* (dhe variantet, nuk janë italishtë!), *mjegull*, *hyll*, *dimën*, *ditë*, *natë* (në farefisni me ital. *notte*, por nuk është fjalë e huajtun!), *lindje*, *perëndim* (nuk është latinishtë!), *kohë*, *zjarm*, *djeg*,

thëngjill, etj., edhe pse këtu ka mjaft fjalë të huajtuna (*breg*, *jug*, *mal*, *malsi*, *prendverë*, *drû* etj.) por, për këtë me nji rast tjetër.

Edhe vetit e ndryshme që i tregon materja, thirren me fjalë shqipe vendase: *thatë*, *ngrohtë*, *ftoftë*, *idhtë*, *athët*, *bardhë*, *zi-zezë* (por *kuq*, *verdh*, tosk. *gjelbërë* rrjedh edhe prej latinishtes!); *i madh*, *i vogël*, *i tanë*, *i gjatë*, *i ulët*, *i gjanë*, *i ngushtë*, *i ri*, *i lashtë* etj.

Mbas kësaj gjejmë edhe nji varg drûjsh e bimësh me emna vendas: *ah*, *vidh*, *bredh*, *borig*, *blî*, *gjeth*, *bar*, *modhullë*, *mand*; si dhe kafshë t'egra e të damshme: *ujk*, (ulk, në farefisin me fj. maq. Volk, por nuk âsht fjalë e huajtun) e *dhel-pën*, *mi e zog*, *ari e drê*, *shpend e shqype*, *gjarpën e zhapi* e shum tjera.

Kaq për konceptacionet prej rreshtit të njeriut dhe prej natyrës së lirë që e rrethon.

Rastet më të ndërlikueme janë, kur duem me analizue at fond terminologjik, që i përket civilizimit e kulturës. Analiza e fjalorit të shqipes tregon, marrun përgjithsisht, në shum raste ndikesë të huej në këtë: ndikesa e Romakëve në jetën juridike të Shqiptarëve, ndikesa e Sllavëve në bujqësin shqiptare, ndikesa e Turqve, Italjanëve, Grekëve e Sërbëve n'arkitekturë, në përpunimin e pëlhurave etj. (për të gjitha këto do të shkruej njiherë tjetër.) Por, përkundrejt kësaj ka edhe në lamit kulturore mjaft elemente të ruejtuna vendase (trakase).

Asht e faktueme se kaherë Shqiptarët kanë qenë të parët në Ballkan që janë marrë me jetën dhe organizatën blegtore. Prandej âsht fare e natyrshme që ata në degën e blegtoris nuk kanë pasë ndikesa të hueja. Sëkëndejmi rrjedh edhe kjo që terminologjija blegtoreale shqipe, shum e përhapun, ka në masën e saj themelore shprehimisht karakter vendas.

Fjalë të vjetra vendase janë *qumsht e gjizë*, *dhallë e makë*, *mish e lëkurë*, *lesh e djath!* Simbas kësaj, nuk âsht çudi që edhe kafshët shtëpijake të dobishme, gati papërjashtim, kanë ruejtë emnat e vjetër vendas. Të gjitha këto janë fjalë vendase: *dele*, *qingj*, *dash*, *dhí*, *edh*, *sqap* (cjap, çap), *ká*, *lopë*, *dem*, *mushk klysh*, *derr*, *dosë*, *shotë*, *mandej kërrutë* (nuk âsht latinishte!), *shileg*, *bagëti*, *shtrungë*, *tredh* (në kuptimin blegtoral), si dhe fjalët e prejardhuna si: *lop-ar*, *dhi-ar* etj. Prej termineve më të randsishme janë të hueja (latinishte) *kal* (=cavallus), dhe *qën* (= Canis), por megjithkëte fjala *bushtër* prap âsht vendase. Simbas disave edhe fjala *magar* (prej së cilës sërbisht *magarac*) âsht fjalë e vjetër trakase, pra fjalë shqipe vendase (por fjala gomar ka origjinë greke!).

Kultura origjinale trakase për mbarështimin e bagëtive kanë rrâjë te populli shqiptar, saqë në kët degë Shqiptarët, jo vetëm që kanë ruejtë fondin e fjalorit të tyne të vjetër, por ua kanë dhanë edhe popuje tjerë, sidomos në Ballkan, si edhe jashtë Ballkanit. Kështu *shtrungë*, termin specifik blegtoral, kaherë âsht përhapë në të gjitha gjuhët ballkanike: sërbokroat. *struga*, bullg. *str'ga*, rumun. *strungă*, mandej prej rumunishtes mâtëj në gjuhët ukrainishte, çekishte e polonishte. Fjala shqipe *dhallë* ka kalue shum heret në gjuhën rumunishte si *zara* (zer), e prej Rumunëve edhe te Serbët si *zarica* e te Ukrainasit e Polakët (Z'er etj.). Edhe fjalën *sqap*, *çap* e kanë marrë popujt e ndryshëm të Ballkanit. Asht interesant që edhe fjala sërbokroat. *balega*, rumun. *baligă* — âsht sajue prej fjalës shqipe *balgë*, *bagël*. E tjetra. Shkoqitja detale e kësaj çashanje nuk i përkët këtij artikulli.

Jashtë blegtorisë Shqiptarët kanë ruejtë në sistemin ekonomik diçka mâtë pak elemente. Megjithatë âsht me randsi me nënvizue që edhe në degën e bujqsis, përpos fjalëve të huajtuna latine, e sidomos sllave, gjinden edhe disa fjalë të vjetra vendase me randsi, sikurse ka argumentue në kohën e vet i ndyeri albanolog gjerman Jokl-i. Në fjalët vendase duhet me numrue edhe këto shprehje me randsi: *drith*, *grun*, *elb*, mandej *drithnik* (me mbrapashtesën sllave) *pluar*, *shtizë* (pjessë e plugut) e ndoshta edhe fjala *parmendë*.

Tekembramja prej kulturës tjetër materiale po paraqesim shprehje të ndryshme që janë krijuar në vend, si: *lugë*, *luguruzhdë*, *thikë*, *majth*, *mreçë*, *pê* (*pë*), *shul*, *shtizë*, *dorëzë*, *shteg*, *derë*, *shqezë*, *shkop*, *zgjedhë*, *anë*, *vorbë*, *vegsh*, *vargue*, *me tjerrë*, ndoshta edhe *sulë* („barkë”, sllav.?), por ka edhe nji varg shprehjesh tjetra të këtij lloji.

Mâtë fund formacionet patriarkale shoqnonore, dhe çfaqjet e tyne, gjithashtu mbajnë emna vendas, që âsht edhe fare e logjikshme, sepse këto poashtu janë krijesa origjinale të vetë popullit shqiptar. Me origjinë vendase janë fjalët: *fis*, *fis-niki* (dikur trajtohej gabimisht si fjalë e huajtun prej greq. *fysis*, që do të thotë „natyrë”). Mandej fjala *katund* (përkundrejt shprehjes *qytet*, e cila âsht me origjinë latine); si edhe organizata blegtorelle *bjeshkë* (*bjeshka-tar*, këshilli i fisit *pleqní* (prej fjalës vendase *plak*), e ndoshta edhe fjala *kuvend* (nëse âsht prej fjalës vendase *vend*, e jo prej latinishtes *Conventus*).

Prej kategorive psikologjiko-shoqnonore theksohet sidomos institucioni specifik shqiptar *besë* (kët fjalë e kanë marrë edhe popujt tjerë ballkanas e deri edhe Turqit). Kjo âsht fjalë e vjetër indoeuropjane. Edhe koncepcioni „*čojstvo i junastvo*” janë emna vendas: *trimni*, *njer(ë)zi*. Mandej janë indigjene

edhe shum shprehje tjera që shënojnë gjendjet shpirtnore dhe kualitet morale: *mirë e keq, i butë e zemrak, i urtë e i trashë, trim e tutës, i shkathët e i ngathët*, edhe shum tjera, ndonse këtu ka poashtu edhe shprehje latinishte, sllavishte e turqishte (sidomos turqishte).

Mbas kësaj pasqyre fare të shkurtë, kur t'i hedhim nji shiqim materialit t'analizuem të fjalorit të gjuhës shqipe, atëherë — përpos paplotnís që na âsht imponue për shkak të vendit — na del parasysh nji fëtyrë bukur e qartë e asaj rrethane, në të cilën âsht sajue gjuha e të parëve të Shqiptarëve të sodshëm. Ajo ka qenë nji rrethanë tipike patriarkale blegtorale, me nji kuptim fort të zhvilluem për jetën e vendit, me njeriun që njifte mirë natyrën në të cilën jetonte, i cili mbarështonte me shumicë bagëtin e tij, tue luftue me kët rast me skamjet, që impononte natyra dhe bota e shtazëve t'egra. I pari i Shqiptarit të sodshëm ka qenë kryesisht blegtuer, punues bylmeti, lëkurash e leshi, ka mbarështue bagëtin e imtë e të trashë; por ka njoftë edhe bujqsin, edhepse kjo ndodhej në nji shkallë tepër primitve. Këtij formacioni të vjetër të blegtorëve patriarkalë i përgjigjej edhe organizata fisnore patriarkale me format e veta të përpunueme.

Qe, kjo âsht fëtyra e parahistoris shqiptare, sikurse na e paraqet analiza linguistike. Ky në të vërtetë, âsht mû asi ambienti si e shënon historija antike për Trakasit, Ilirët, si dhe për auktoktonët e atëhershëm primitivë ballkanikë.

Ardhja në kontakt e këtyne fiseve me civilizimin romak dhe me shoqnin sllave, tipikisht bujqsore, në Kohë të Mesme do të thonte për të parët e Shqiptarëve, nga nji anë robní, por nga ana tjetër përsosmënë e degëve të ndryshme të jetës shoqnore. Ndikesa latine e sllave ka lanë gjurma të thella në disa degë të jetesës së popullit shqiptar, për të cilën gjëna dishmojnë më së miri edhe vëzhgimet gjuhsore. Por, për këte do të flas nji herë tjetër.

Dr. Ivan POPOVIĆ